



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:073770
Datë: 15.02.2021
Numri i dokumentit: 01506428

P.nr.13/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, dhe me sekretaren juridike Behije Karaçica në çështjen penale ndaj të akuzuarit A. B. për shkak të veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës PP/II.nr.1677/2018 dt.21.01.2019, pas mbajtjes të shqyrtimit të dytë, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Nazmi Krasniqi, si dhe i akuzuari A. B. me mbrojtësin e tij av.N. K. dhe përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës së mitur- K. B., me dt. 22.01.2021, shpallë këtë, ndërsa me dt.15.02.2021 përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: A. B. nga i ati K., dhe ëma A. e lindjes K., i lindur më datën ..., në fshatin B., Komuna e M., ku edhe jeton, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i ati i ... fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se me datë 14.08.2018, rreth orës 14:00 minuta, në fshatin B., Komuna e Malishevës, nga pakujdesia, shkakton rrezik të përgjithshëm për jetën e njerëzve, në atë mënyrë që e len qenin e tij në oborrin e tij pa u siguruar se i njëjti mund të zgjidhet nga zingjiret, ashtu që qeni zgjidhet nga zingjiret, del nga oborri i shtëpisë në rrugë dhe derisa aty pranë shtëpisë së të pandehurit ishte duke kaluar e dëmtuara/ e mitura G.B, e njëjta sulmohet nga qeni i të pandehurit i cili pasi e kafshon në dorën e majtë e përplas për disa rrethoja aty, me ç'rast të dëmtuarës/të miturës G.B i shkakton lëndimet të lehta trupore, lëndime të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr.V. H. të dt.05.12.2018.

-me çka ka kryer veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.6 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 46, 47, 48, 49 dhe nenit 69 të KPRK-së (Kodit nr.06/L-074), si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të njëjtit ia shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarin e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale.

Obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumën prej 30.00 euro, si dhe shumën prej 30.00 euro për programin mbi kompensimin e viktimave të krimit, si dhe shumën prej 20.00 euro për ekspertizë mjeko-ligjore, ndërsa shpenzime tjera nuk ka pasur. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të behet me detyrim.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1677/2018 të dt.21.01.2019, e ka akuzuar A. B., për shkak të veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragraf.6 lidhur me paragraf.1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit të dytë me dt. 21.01.2021, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit Nazmi Krasniqi, i akuzuari A. B. me mbrojtësin e tij av. N. K.me autorizim në shkresat e lëndës, si dhe përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës së mitur – prindi K.B., andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit të dytë.

I pandehuri në shqyrtimin e dytë është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se më vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, ku me familjen e të dëmtuarës së miturës G. B., respektivisht me prindin e saj K. B. jemi pajtuar, pasi që edhe jemi kushërinj dhe nuk kemi ndonjë problem në mes vete që nga ai rast kur ka ndodhur.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av.N. K. ka deklaruar: Meqenëse i mbrojturi im e ka pranuar veprën sipas aktakuzës, kërkojë nga gjykata që të merr parasysh të gjitha lehtësitë ligjore që i ofrohen. Përveç kësaj i mbrojturi im rreth kësaj vepre është rregulluar me të dëmtuarin, ashtu që janë pajtuar, dhe janë kushërinj të afërm, shprehë keqardhjen e tij që rasti ka ndodhur, dhe nga gjykata kërkon që gjatë marrjes së aktgjykimit të ketë parasysh të gjitha këto rrethana të matjes së dënimit, pasi që edhe i njëjti është në tretman të vazhdueshëm mjekësor, ku gjykatës ia dorëzoj edhe dëshminë e mjekut.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës G. B., prindi K. B. gjatë shqyrtimit të dytë ka deklaruar se nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë, nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale ndaj të akuzuarit dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike, dhe deklaroi se jemi pajtuar po ashtu jemi fqinj kalojmë mirë shumë në mes vete dhe nuk kemi kurrfarë problemi.

Prokurori i shtetit Nazmi Krasniqi, në shqyrtimin e dytë ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit A. B., pasi që një pranim i tillë gjen mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i akuzuari dhe atë pas këshillimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, andaj i propozojmë gjykatës që këtë shprehje të lirë të vullnetit ta aprovoj dhe ndaj të njëjtit të shqiptoj dënim sipas ligjit dhe

atë duke marr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me dispozitat e Kodit Penal.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin e dytë vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari A. B., me dashje ka kryer veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.6 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së (Kodit nr. 04/L-082), dhe gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Raporti fillestar i incidentit i dt.15.08.2018;
- Deklarata e të dëmtuarës G. B. e dhënë në Polici me dt.15.08.2018 dhe në Prokurori me dt.18.12.2018;
- Deklarata e të pandehurit A. B., e dhënë në Polici me dt.15.08.2019 dhe në Prokurori me dt.18.01.2019;
- Raporti i Policisë, i dt.15.08.2018;
- Raporti mjekësor i dt.14.08.2018 nga QKUK P.;
- Ekspertiza mjeko-ligjore e dt.05.12.2018, dhe
- Fotoalbumi

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 365 paragrafi 6 të KPRK-së, është parashikuar se “Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”, ndërsa në par.1 është parashikuar se formën themelore të veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm e kryen: “Kushdo që me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve, eksplozivit, helmit ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, me energji elektrike ose me ndonjë lloj energjie tjetër, ose me ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm apo mjete të rrezikshme, shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”.

5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin A.B.e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, ngase në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.6 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodit nr.06/L-074), për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së (kodi nr.06/L-074), të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë, pendimin e tij, është i ati i 5 (pesë) fëmijëve, mbajtës i familjes ... anëtarësh, asnjëri i punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, familjen e mban me punë në bujqësi, me prindin e të dëmtuarës janë pajtuar, sjellja e tij korrekte në shqyrtim, përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës – prindi i saj nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike, dhe sqaron se të njëjtit janë pajtuar dhe kalojnë shumë mirë, dhe nuk kanë asnjë problem mes vete, kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht (dënimin me burg në kohëzgjatje prej 5 muajve), i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit prej një 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074), dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës së mitur –prindi K. B. nuk është udhëzuar në kontest civil, pasi që i njëjti në shqyrtimin e dytë ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale gjykata e mbështeti në nenin 450 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË **P.nr.13/19, me dt.22.01.2021**

Sekretare juridike
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.